



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 257 Prot.

Durrës, më 07.03.2017

LETËR REFERENCE

Nëpërmjet kësaj Letër Reference, Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës shpreh mirënjohjen për bashkëpunimin në interes të të drejtave të fëmijëve me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori).

Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës ka bashkëpunuar me Observatorin që në qershor të vitit 2015 në zbatimin e nismës “Çdo fëmijë në shkollë” me synim identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve në moshë të detyrimit shkollor si edhe parandalimin e braktisjes së shkollës. Nëpërmjet pilotimit të zbatimit të kësaj nisme në Durrës, Observatori ka kontribuar në *ngritjen e praktikave dhe mekanizmave në përshtatje me standardet aktuale ndërkombëtare* për bashkëpunimin institucional në adresim të identifikimit dhe regjistrimit në shkollë të të gjithë fëmijëve që i përkasin moshës së detyrimit shkollor.

Në zbatimin e kësaj nisme, Observatori ka kontribuar në krijimin e një *mjedisi harmonik, miqësor për fëmijët dhe me një frymë edukuese*. Ekspertiza e stafit të Observatorit ka shërbyer edhe në ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e stafit shkollor dhe institucioneve lokale të mirëqenies sociale në Durrës për çështje të rëndësishme sociale dhe arsimore.

Institucioni i Prefektit të qarkut Durrës uron që Observatori të jetë pjesë e rrjetit zbatues të nismave të ndryshme me fokus vëzhgimet, kërkimet dhe analizat, komunikimin dhe advokacinë, si edhe e rekomandojmë Observatorin si një organizatë partnere për zbatimin e programeve në fushën e edukimit në Shqipëri.

Me respekt,

PREFEKTI

Rolant XHELLAJ

